



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 25/2015

Prishtinë, më 14.7.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI**

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Sasha Milosavleviq, Raif Qela, Sala Berisha - Shala, Blerim Grainca, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Besim Beqaj dhe Fatmir Rexhepi, anëtarë.

Pjesëmarrës i ftuar: Ekrem Hoxha, kryetari i Bordit i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Pjesëmarrës të tjerë: Ilir Imeri, Nazim Rahimi dhe Visar Halimi - ARKEP; Ismail Shabani - Kosova Press; Muharrem Saragjollli - Radio Kosova; Tringa Bytyçi - GLPS; Kushtrim Ahmeti - KTV; Visar Berisha - INDEP; Sylejman Blaku - Kosova Sot; Lumniye Murati - ZPRK; Albulena Mavraj- Epoka e Re; Besa Berisha dhe Arta Xhylani- UNDP (praktikante).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 7.7.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014;
4. Te ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.7.2015;

Procesverbali nga mbledhja e datës 7.7.2015, u miratua me plotësimin dhënë nga kryetari i komisionit, Muhamet Mustafa, për pikën e tretë të rendit të ditës “Raportim i përfaqësuesve të ministrive të linjës, lidhur me realizimin e rekomandimeve të dala nga Raporti i Progresit” si vijon:

“Këto janë çështjet kyçe të cilësisë të jetesës dhe demokracisë dhe të zhvillimit të shpejtuar të Kosovës.”

“Përfundim

Komisioni në bazë të Planit të punës do të vazhdojë me prioritet të tij mbikëqyrjen dhe monitorimin nga afër punën e tri ministrive që ka në fushëveprim, në adresimin dhe përmbushjen e sfidave të paraqitura në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian dhe gjatë kësaj mbledhje.”

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014;

Muhamet Mustafa , kryetar i Komisionit, tha se për këtë pikë sot kemi të ftuar përfaqësuesin e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare – ARKEP, për të paraqitur Raportin vjetor për vitin 2014 dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Ai shtoi se i pranishëm nga ARKEP-i është Ekrem Hoxha, kryetari i Bordit të ARKEP-it. Ne kemi pranuar një raport nga ARKEP-ja, për vitin 2014 dhe ky raport jep mjaft informata të dobishme lidhur me aktivitetet e këtij rregullatori dhe lidhur me situatën në këtë fushë jashtëzakonisht të rëndësishme për Kosovën. Mustafa tha se për neve janë të rëndësishme 3-4 gjëra, të cilat duhet t’i diskutojmë. E para është si qëndrojmë me sasinë dhe cilësinë e shërbimit në fushën e komunikimeve elektronike, në fushën e telekomunikimeve, ku dhe sa po zhvillohemi në raport me rajonin, sa janë arritur këto standarde sa i përket sasisë dhe cilësisë. Çështja tjetër ka të bëjmë me sigurimin e elementeve të tregut të hapur, në kuadër të cilit ne duhet të kemi kujdes për industrinë vendore, por duke pasur një konkurrencë korrekte që është në interesin më të mirë të konsumatorëve. Raporti sigurisht ka dhënë përgjigjeje në disa çështjeje të rëndësishme por ajo që shihet edhe në raportin në përgjithësi ka të bëjë me ndryshimet radikale në strukturën dhe cilësinë e shërbimeve që po i kërkon fleksibiliteti dhe këto ndryshime të strukturës së tregut dhe kërkesës se konsumatorëve disa operatorë kanë fleksibilitet më të madh, disa më të vogël dhe riorientimet në bazë të kësaj strukture si duket kanë probleme të mëdha veçanërisht në ndërmarrjet publike deri më tani. Telekomit i Kosovës ka ardhur më pozitivisht të vështirë, për shkak të situatës që ka qenë atje deri në një kohë të problemeve rreth privatizimit dhe të mosaftësisë menaxheriale apo qeverisjes atje që produktet e kësaj ndërmarrjeje të ristrukturohen në pajtim me kërkesat e reja, prandaj janë problemet e fleksibilitetit dhe në këtë drejtim besoj se na sigurisht për këtë çështje do të flasim kur vjen raporti i ndërmarrjeve publike edhe për PTK-në më shumë, por sot kemi më tepër rreth aspektit të rregullimit të tregut.

Ekrem Hoxha, kryetari i Bordit i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, fillimisht paraqiti raportin në vija të përgjithshme të funksionimit, duke paraqitur aktivitetin në mënyrë kronologjike të ARKEP-it. Dihet se çdo organ publik apo organ i administratës qendrore, gjithë veprimtarinë e vetë duhet ta ushtrojë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin e aplikueshëm dhe për këtë sigurojmë themeluesin, Kuvendin e Kosovës se gjithë mandatin dhe ushtrimin e veprimtarisë gjatë vitit 2014 dhe vitet paraprake ka qenë në përputhje me Kushtetutën, me ligjet e aplikueshme. Qëllimi parësor i ligjit themelor, ligjit për komunikime

elektronike dhe ligjit për shërbime postare të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës janë që të mundësojnë konkurshmërinë në treg, një treg i hapur bazuar në konkurrencë korrekte dhe efektive, shfrytëzim efikas i resurseve fundore që janë frekuenca dhe enumeracionet. Kryetari foli edhe për ndikimet që ka pas konvergjenca teknologjike dhe neutraliteti teknologjik dhe për këtë do t'i referohemi me shifra me të dhëna kryesore dhe zbatimin për parime themelore të atij të proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit gjatë nxjerrjes së akteve rregullatore. Gjatë vitit 2014 Bordi i autoritetit ka nxjerr 130 vendime të karakterit rregullator dhe atyre që ndërlidhen me veprimtarinë ekzekutive të institucionit, gjithashtu 6 rregullore të reja dhe 1 rregullore të vjetër e ka plotësuar dhe ndryshuar, ka zgjedhur 2 raste lidhur me mosmarrëveshjeve midis subjekteve të autorizuar, pra operatorëve dhe subjekteve të ndryshme, gjithashtu ka zgjedhur 35 raste të ankesave të konsumatorëve fundorë, këtu po flasim vetëm për të dhëna formale se keni parë autoriteti gjatë vitit pranon rreth 1.000 shkresa, 860 saktësisht kanë qenë vitin e kaluar, të gjitha ato trajtohen një nga një në këshilla, udhëzime, rekomandime para se të përfundojnë si rast, i cili kërkon ndërhyrjen tonë rregullatorë. Pra, në vitin e kaluar kemi pasur 35 raste të konsumatorëve fundorë ndaj operatorëve. Gjatë vitit 2014, tregu ka pasur një rritje në krahasim, kur krahasohet me indikatorin e përdoruesve fundorë, pra kemi arritur në mbi 1.73 milion përdorues aktiv, që së paku njëherë e kanë përdorur pajisjen fundore brenda periudhës 90 ditore, krahasuar me 1.64 milion në fund të vitit 2013, që do të thotë kemi pasur një rritje prej 5.3%. Po ashtu, numri i përdoruesve të shërbimeve të internetit që përfshin kabllor, internet dhe telefoni fikse ka pasur një rritje prej 13.6%. Tek përdoruesi i telefonisë mobile gjithashtu kemi një rritje prej 4.76%, që do të thotë se kemi një numër të rritjes përdoruese. Rritja më domethënëse që ka ndodhur vitin e kaluar, në vitin 2014, ka qenë numri i përdoruesve me akses broadband apo shërbimeve që i themi ne, që i referohen 3G apo 4G, në pasjet mobile apo me pajisjet fundore, ka arritur në 283.989 përdorues, krahasuar me gjendje e mëherëshme që ka qenë 104.769 përdorues, pra kemi rritje prej 171.06 % këtë vit. Sipas operatorëve, operatori Vala ka pas një rënie më të madhe prej 23.8%, IPKO pati rënie prej 3% dhe operatorët virtual rënie dy prej tyre ka pasur rënie prej 17.8%. Sektori i shërbimeve postare, nëse e krahasojmë nga viti më vit, në vitin paraprak në numër të dërgesave vërejmë një rënie në masën prej 1.04%, ndërsa për operatorë të ndara sipas pronësisë, Posta e Kosovës ka pasur një rritje prej 7.16%, ndërsa 10 operatorë privat që operojnë në postë të shpejt ka regjistruar një rritje prej 11%. Gjatë periudhës në fund të viti 2013 dhe në fillim të vitit 2014, operatorët e autorizuar dhe ofruesit e shërbimeve kanë realizuar rreth 52 milionë euro investime të reja, në zgjerimin dhe modernizimin e rrjeteve infrastrukturore, që paraqet në vlerësimin e rregullatorëve një bazë të qëndrueshme për avancimin e konkurrencës mbi bazën e infrastrukturës ekzistuese dhe arritjen e objektivave zhvillimore, që ofron qasje në vendet rurale, që është një prej objektivave kryesore. Vitin e kaluar kemi lëshuar 44 autorizime apo konfirmime të njoftimeve, për gjithsej 88 aktivitete, për 17 ndërmarrje të reja, pra një ndërmarrje mund të ketë aktivitete të ndryshme. Tek menaxhimi i resurseve frekuencore autoriteti ka arritur indikator ato të planifikimit financiar dhe menaxherial, ka lëshuar gjithsej 212 autorizime individuale (licenca) për shfrytëzim të kanaleve frekuencore dhe ka lëshuar 55 licenca për radio-amatorë të rinj vendorë dhe 3 licenca për radio amatorë, shtetas të huaj. Për herë të parë në vitin 2014, autoriteti ka filluar të bëjë matjen kuantitative të kualitetit të shërbimeve për transmetimet me zë dhe SMS-ve, pra për ata që janë të interesuar në sektor, për herë të parë autoriteti ka publikuar një raport të detajuar ku konsumatori e ka informacionin për çdo kualitet, parametër të kualitetit për operatorë dhe mund të ka vendimmarrje të bazuar se cilin shërbim do ta merr. Gjatë vitit 2014 gjithashtu autoriteti ka zhvilluar një implementim të rëndësishëm pajisur me teknologji të avancuar të fjalës së fundit për matjen e shërbimeve 3G dhe 4G, dhe falë këtyre pajisjeve por edhe pajisjeve paraprake, kemi realizuar 59 matje. Një zhvillim tjetër me rëndësi është edhe ai gjatë vitit 2014, ARKEP-i është pranuar si organ i Republikës së Kosovës me të drejtat e anëtarit vëzhgues në grupin punues të “ECO-së”, “ECO” është një organizëm i Bashkimit Evropian. Telefonja fikse në vendin tonë ka pasur një trend të rënies prej 18.2%, do të thotë ka pasur zbritje prej 64.300 përdoruesve, krahasuar me vitin e kaluar 2013, që ishte 78.600 përdorues. Pjesa prej rreth 53 mijë përdoruesish të shërbimeve të telefonisë fikse i

takon Telekomit të Kosovës, kurse pjesa tjetër prej 10 mijë përdoruesve i takon operatorit alternative IPKO dhe pjesa prej 864 përdoruesish i takon operatorit Kujtesa/ Net, i cili për herë të parë gjatë këtij viti ka filluar me operimin shërbimeve të telefonisë fikse. Gjatë vitit 2014 kemi pasur investime kapitale në fibrin optik, pra si një infrastrukturë modern e cila mundëson kapacitet të internetit të shpejt, këtu Kosova qëndron mirë krahasuar me vendet e regjionit edhe me shërbimet kabllore. Dua të paraqes një shqetësim tek Komisioni Funkcional, ku ne raportojmë se tash e 3 vite me radhë autoriteti me qarkore buxhetore nga Ministria e Financave i rrezikohet funksionaliteti i mirëfilltë i institucionit. Ne i kemi gjithsej 39 veta të punësuar, të lejuar nga Kuvendi, ndërsa rregullatori më i vogël në regjion i ka 60 punonjës, ndërsa mesatarja në regjion është 110 punonjës, pra ky është vetëm një tregues jo doemos sasia tregon kualitetin por me të vërtetë jemi ngushtë me numër të personelit dhe kërkojmë një mirëkuptim dhe përkrahje nga Komisioni që gjatë shqyrtimit buxhetor mos preket pavarësia funksionale sepse në vitin e fundit tash edhe në rishikim janë shkurtua 52 mijë euro për paga dhe mëditje dhe më këto shkurtime vihet në pikëpyetje efikasiteti i rregullatorit dhe ne kërkojmë një përkrahje apo vëmendje nga ju.

Kryetari tha se raporti është mjaft i gjerë, megjithatë disa çështje duhet të na sqarohen pas diskutimit. Unë për fillim mendoj se na nevojitet një sqarim në raport pse përkundër shkurtimeve që i keni pasur në buxhet, siç thatë edhe ju, me rishikimin e buxhetit janë zvogëluar prapëseprapë këtë pjesën e investimeve publike, do të ishte mirë të na informoni pse nuk është realizuar. E dyta, nuk kam pa diçka si është gjendja në mes operatorëve ilegalë? Kjo është një çështje kyçe për neve edhe për nivelin e konkurrencës. Çka keni ndërmarrë? Cilat janë aktivitetet e juaja? Çështja e tretë ka të bëjë me hyrësit e ri, mjaft i kënaqur me numrin e hyrësve të ri në treg diku rreth 17 ndërmarrje, por nuk kemi një sqarim se cilat fusha janë? Çka kanë sjellë këta hyrës të ri? Çfarë cilësie kanë sjellë në tregun e shërbimeve elektronike? Gjithashtu, edhe për ankesat, neve si komision na intereson natyra e ankesave, jo vetëm numri i ankesave. Ku është problemi që i tangon konsumatorët? Çështjet e buxhetit ju lutem që ta bëni me një analizë, ne jemi të interesuar si komision që pavarësia buxhetore të sigurohet bashkë me transparencën dhe llogaridhënien buxhetore dhe se çështja e vendimeve buxhetore mos të ndikojë që ARKEP- i mos të ketë një pavarësi qysh ja garanton ligji.

Visar Ymeri - Tek çështja e operatorëve ilegalë që e potencoi edhe kryetari, kur ka pas raportuar herëve të kaluara lidhur me operatorët ilegalë, mendoj se duhet t'ia bëni një shpjegim komisionit lidhur më këtë meqenëse keni qenë i përfshirë në marrëveshjet për telekomunikacion që është arritur në mes Qeverisë së Republikës të Kosovës dhe asaj të Serbisë. Një çështje tjetër që kisha dashtë me e ngritë është edhe te shfrytëzimi ose tek frekuencat brezgjëra, është raportuar në media edhe nuk e di sa qëndron kjo, por do të doja një shpjegim se njëra prej arsyeve pse shërbimet brezgjëra nuk po funksionojnë siç duhet nga operatorët që i ofrojnë ato qoftë nga IPKO, apo nga Vala, është për shkak të mungesës së gjerësisë së caktuar dhe të nevojshme të frekuencave. Çfarë keni bërë në këtë drejtim, apo si e keni ndërmend ta shmangni këtë problem? Sa i përket rënies së të hyrave të përgjithshme të tregut dhe të ngritjes së përdoruesve, a mund të na shpjegoni cili është shkaku i kësaj? A është rënia e çmimeve? E kemi në raport të vitit 2013, shihet megjithatë që IPKO-ja e ka një rritje të të hyrave, ndërsa te Vala kemi rënie të të hyrave, pra po flas për faqen 91 të raportit dhe kemi një ngritje të ndjeshme të të hyrave të Z-mobile, ndërkohë që sa i përket këtij operatori tjetër virtual, ai është praktikisht inekzistent. Sipas raportit 2013, thuajse nuk ka operuar fare kjo 0.10% që ka pasur në fund të pjesës së të hyrave nga tregu i përgjithshëm. Në këtë drejtim çka po e shkakton të rënien e Val-ës në përgjithësi? A është konkurrenca me IPKO-n apo me Z-mobile-n?

Kryetari duke e plotësuar deputetin Visar Ymeri që theksoi se neve na intereson se a është kontrata me Z-mobile-n nga aspekti i rregullatorit një konkurrencë korrekte me Vala-n, sepse neve na intereson konkurrenca korrekte e jo emrat e operatorëve.

Visar Ymeri tha se në këtë rast e kemi situatën shumë të qartë. E kemi kompaninë publike që e ka pasur një kontratë e cila është përfolur shumë edhe për të cilën ka pasur hetime nga prokuroria, një kontratë e cila në këtë aspekt po e dëmton kompaninë publike. Dhe për fund keni një numër të sfidave që i keni rëndit në raport, për të cilat nuk keni dhënë ndonjë sqarim se në çfarë mënyre dhe si do ti trajtojë ARKEP-i?

Blerim Grainca tha se është bërë pothuajse rregull që raportet e agjencive të shqyrtohen me vonesë edhe në Kuvend edhe në komisione. Në aspektin ligjor shqyrtohen në 3 mujorin e parë, ndërsa tani jemi në korrik, më intereson pse janë këto vonesa ? Dhe, po ashtu në sfidat që i keni përmendur, mungesën e bordit, sa ka ndikuar mospasja e autorizimeve reale sepse me ligj ata do të kenë autorizime deri sa të bëhet ligji i ri, si bord a ka ndikuar kjo në punën tuaj. Po ashtu, keni paraqitur çështjen e pavarësisë financiare, megjithatë ju e dini se ligji për financa publike e rregullon këtë punë, kurse tek investimet kapitale ju keni thënë në raport se me rishikim janë marrë 205 mijë euro, kurse në raportin e auditimit për vitin 2013, keni një varg sfidash dhe problemesh që i ka ngritur auditori për mosrealizim të investimeve kapitale, do të thotë, me rishikim a janë marrë këto mjete për vitin 2013, nuk keni arritur të realizoni investimet kapitale apo janë marrë vetëm pse janë dashur apo për arsye të tjera? Rreth ankesave, nuk keni dhënë një shpjegim të natyrave të ankesave. Tek raportet monitoruese dhe inspektuese do të duhej të na njoftoni për gjetjet, ju keni bërë inspektime në terren, keni mbikëqyrë operatorët në këtë fushë, por nuk keni dhënë një shpjegim të asaj se çka keni gjet. Te çështja e tarifave thuhet se janë tarifa e njëjta edhe sikur komunikimet nacionale edhe për ato jashtë vendit, a është kjo praktikë apo ndodh vetëm tek ne?

Pal Lekaj tha se ajo që vlen të diskutohet është një raport që për nga përmbajtja është mirë i thurur dhe ajo që bie në sy që të gjitha shërbimet që kryhen janë në nivelin më të lart të mundshëm. Komunikimi që nuk korrespondon me ankesat e qytetarëve si p.sh. 3G dhe 4G. Unë 4G, kur nuk e kam pas në telefon, por ju e proklamoni çdo herë që kemi shërbime të mira. Sa i përket operatorëve virtualë, ne e dimë që një sipërfaqe të madhe e mbulojnë dhe deri më tani nuk kemi mundur që të jemi të saktë dhe t'i ndërpresim këto operatorë ilegalë. Tjetra, një sipërfaqe e hapësirës së Kosovës dihet se është jashtë rrjetit me ndërhyrje të shteteve fqinje dhe prapë në këtë drejtim nuk kemi marrë masa dhe këtu dëmtohet qytetari jonë. Tash jemi edhe në bisedime me Serbinë, me operatorin e tretë, çka mendoni, ju pse kjo është çështje politike?

Raif Qela- Raporti i ARKEP-it është punuar me kujdes, siç duket i ka përfshirë të gjitha çështjet të cilat duhet të adresohen në një raport, prandaj si të tillë mendoj se duhet ta miratojmë meqenëse është i punuar siç duhet. Mirëpo aty janë të adresuar edhe do çështje, të cilat kanë treguar edhe lëshime në fushën e prokurimit publik, përderisa ka lëshime në procedurat e prokurimit publik, lëshime të cilat i ka gjetur edhe auditori, e pyes rregullatorin se çfarë masa kanë ndërmarrë, në mënyrë që në të ardhmen të mos lejohen lëshime të tilla? Dhe e dyta çka kanë ndërmarrë operatori në mënyrë që reklamat, të cilat i bëjnë telefonitë mobile pa mbulesë, në të cilat paraqesin se shërbimet janë krejt falas siç thuhet, e në të vërtetë ato janë me pagesë, çfarë masa kanë ndërmarrë në mënyrë që të mos i servohen të dhëna të gabueshme publikut dhe në këtë mënyrë të ndikojnë edhe në konkurrencën e lirë.

Ekrem Hoxha – ARKEP, tha se tek menaxhimi i buxhetit dhe ndikimet e ligjit për menaxhimin e financave publike dhe ligjit tonë për komunikime elektronike, me nenin 64 - 66 përcaktohen saktë se cilat janë organet qendrore dhe si menaxhohen fondet dhe si hartohet dhe miratohet buxheti nga organet e nivelit qendror dhe cilat financohen nga të hyrat vetjake Ligji për komunikimet elektronike që është ligji jonë bazik në hyrje përcakton saktë se ne financohemi nga të hyrat e mbledhura nga tregu, por problemi është të kolizionin ligjor, në nenin 79 të financimit i autoritetit, kur thuhet se të hyrat e realizuara nga autoriteti derdhen në buxhetin e

Kosovës dhe këtu Ministria e Financave e interpreton këtë dispozitë. Ne mendojmë se interpretimi i bërë nga Ministria e Financave është i kufizuar, i njëanshëm dhe po na trajton në paket si gjitha agjencitë tjera. Raporti i auditorit është raporti i 4-të me radhë që nuk ka asnjë vërejtje me efekt material, disa mosveprime procedurale e që nuk e përcaktojnë substancën, nuk paraqesin shkelje. Tek hyrësit e ri, efekti i hyrësve të ri, vitin e kaluar i kemi pas 17 ndërmarrje të reja, kryesisht këto janë subjekte të vogla që ofrojnë shërbime me vlerë të shtuar dhe e marrin shërbimin nga operatorët e rrjetit kryesisht nga PTK-ja dhe Vala dhe ofrojnë shërbime të ndryshme si lojëra të ndryshme, shërbime të ndryshme të internetit në zonat rurale, pra e plotësojnë atë fotografinë atë mozaikun e vendit tonë duke e ofruar qasjen në tërë vendin. Ende nuk e kemi bërë një analizë për efektin se sa operatorë të vegjël marrin pjesë në tregun e përgjithshëm, por çdo vit ka tregues indikatorë se disa prej tyre kanë filluar të rriten ndjeshëm dhe të fitojnë besimin e konsumatorëve. Për operatorët ilegalë, dua që ta njoftojë komisionin që me fillimin e procesit të dialogut teknik, ku është e përfshirë edhe fusha e telekomunikacionit, natyrisht se edhe obligimet ndërkombëtare që janë marrë e kanë pamundësuar veprimin në veri të vendit, kjo në një moment, për momentin e dytë është situata e sigurisë dhe situata politike e brendshme, mirëpo, e sigurojmë komisionin se nuk ka operime ilegale në territorin e Kosovës, përveç në veriun e vendit dhe se një stacion i transmetuesve gjendet brenda hapësirës së kishës ortodokse në Graçanicë, ku ne na është pamundësuar ndërhyrja për shkak të pakos së Ahtisarit, që garanton moscenim të hapësirës së brendshme. Lidhur me pyetjet rreth interferimit me zonat kufitare, dua të sigurojë komisionin se me raportimin e vitit paraprak dhe arsyeja pse nuk e kemi përfshirë këtë vit, është se nuk e kemi ndryshim të gjendjes. Ishte çështja tjetër, marrëveshja e telekomunikacionit, meqenëse Qeveria u fut në një thes me miratim nga Kuvendi për të arritur një marrëveshje në fushat me ndikim në vendin tonë, edhe marrëveshja e telekomunikacionit na ka mundësuar ndërhyrjen në veri dhe kjo është konfirmuar. Çështja që ishte me interes se a janë reale shërbimet që reklamohen, autoriteti është në fazën finale të përmbylljes të dhënies së kapaciteteve shtesë frekuencor të dy operatorëve të autorizuar. Më 22 korrik, nëse nuk gabohem përfundon faza e këshillimit formal, këshillim i mbyllur vetëm me dy operator. Për detajet e fundit të ndarjes dhe të efekteve financiare mund ti konfirmohemi Kuvendit se autoriteti brenda tre muajve të 3-të të këtij viti do t'i ndanë resurset shtesë me çka operatorët do të kenë edhe këtë aset të munguar të frekuencave shtesë. Këto shqetësime edhe te ne kanë arritur edhe pse jo në rrugë zyrtare, lidhur me çmimin, por jemi në dijeni nga Komisioni Evropian nga të gjitha palët e interesit të vendit, që operatori IPKO, ka ngrit shqetësim mbi lartësinë e çmimit të përcaktuar nga autoriteti. Autoriteti ka shpjeguar përmes dokumenteve zyrtare të cilat janë në faqen e saj. Pyetja që ke çfarë masa keni ndërmarrë për reklamat në propagandën asimetrike, si ta quajmë që nuk përkon me shërbimin, duhet të përkujtojmë se ligjërisht me vendimin numër 400, që është marrë me 1 tetor të vitit 2013, rregullatori ka lejuar shërbimet 3G dhe 4G mbi bazën e parimit të neutralitetit.

Visar Ymeri- Sa i përket operatorëve ilegalë dhe përgjegjësive, marrëveshjet, pra zbatimi i ligjshmërisë, ju thatë se për shkak të obligimeve ndërkombëtare që i ka marrë Kosova, keni pasur të pamundshme ndërhyrjen në disa aspekte në veri të vendit dhe në Manastirin e Graçanicës. Me sa e di unë, as me planin e Ahtisarit, as me ligjin pozitiv në Kosovë, Manastiri i Graçanicës nuk ka të drejtë të shërbejë si stacion për telekomunikacion, se natyrisht aty janë disa rregulla të veçanta që e rregullojnë këto zonat e mbrojtura. Nëse ARKEP-i nuk ka mundësi për të ndërhyrë në kësi raste, atëherë cili prej institucioneve të Kosovës do të duhej ta kishte këtë të drejtë? E dyta që lidhet me këtë, por edhe me operatorët e tjerë ilegalë që i përmendet veçanërisht te kufiri i Kosovës me Serbinë, thoni se për shkak të konfigurimit të terrenit e keni të vështirë të ndërhyni apo mundemi ne me ndërhy na në atë sinjal, që ta bëjmë të paemetueshëm në Kosovë, sepse me sa e di unë, ka pajisje teknologjike, në të cilat pamundësojnë emetimin e atij sinjali në territorin e Kosovës dhe e njëjta gjë do mund të përdoret në secilin rast edhe në rastin e stacionit të Graçanicës dhe në rastin e veriut të vendit etj.

Ekrem Hoxha, ARKEP- Autoriteti gjithë mandatin ka të investuar në ligjin për komunikime elektronike që i referohet vendit tonë, territorit tonë, neni 5 dhe 7 e përcakton Qeverinë dhe ministrinë si organe kompetente për përcaktimin e strategjive dhe objektivave zhvillimore. E potencova se marrëveshja e arritur në parim të dy qeverive me ndërmjetësim të BE-së e mundëson evitimin dhe ndalimin e këtyre dy operimeve ilegale dhe i sjellë në pajtueshmëri me ligjin dhe rregulloret e aplikueshme në vendin tonë. Stacioni transmetues në Manastirin e Graçanicës është stacion i vogël, i cili mbulon me një rreze diametër 3-5 km, pra ka fuqi të vogël bartëse transmetuese për me qenë shqetësim i madh për operatorët, por natyrisht le të kuptohemi se është operim ilegal në vendin tone. Autoriteti ka ndërmarrë masa të gjitha që i takojnë me ligj dhe ka dërguar shkresa dhe kërkesa për largimin dhe ndalimin e operimit të atij stacioni, ka notifikua edhe mekanizma ndërkombëtarë të cilët janë përkujdes deri atëherë për mbikëqyrjen e pavarësisë së Kosovës se ky emetim dhe kjo vendosje brenda territorit të manastirit është në kundërshtim me vetë pakon e Ahtisarit. Tek ndikimi i marrëveshjes e Z-mobile dhe Vala-s ne kemi raportuar në vitet 2011- 2012 dhe këtë vit kemi raporte se shërbimet me vlerë të shtuar, siç janë edhe shërbimet virtuale janë një pasuri, një vlerë e shtuar për sektorin dhe plotësojnë fotografinë nëse nuk gaboje mozaikun e shërbimeve më të mira të ofruara për konsumatorin.

Kryetari tha se e kisha pyetjen më shumë të konkurrencës dhe te konkurrenca korrekte, por është interesant kjo në faqen 91, tek tabelat, shihet se të ardhurat e Vala-s apo përqindja në treg në telefoninë mobile ka ra gati prej 68% në vitin 2011, diku prej 59% në vitin 2014, në raport thotë se 2013-ta duhet të jetë 2014-ta, është gabim teknik apo çka? Në të njëjtën kohë IPKO është rritë prej 31% gati 34%, në të njëjtën kohë Z-mobile prej 0.50 në 6.35% atëherë në këtë aspekt pyes.

Ekrem Hoxha ARKEP, tha se qëllimi primar pse ekziston rregullatori dhe ligji, cili është qëllimi, shtrirja për komunikime elektronike është promovimi i konkurueshmërisë dhe liberalizimi i mëtejshëm i tregut. Lëvizjet e parametrave ndikojnë dhe janë indikatorë në mes operatorëve, ata tregues të punës së shëndosh dhe efektive në një treg të hapur, kështu e lexojmë ne si rregullator. Sa i përket asaj se a janë marrëveshjet komerciale, e thash edhe me herët se rregullatori në detyrë zyrtare që e ka për obligim me shikua se a janë marrëveshjet në përputhje me ligjin dhe politikat në qoftë se, po natyrisht ato miratohen si të tilla dhe ne nuk kemi pasur ndonjë shqetësim lidhur me këtë.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë :

R e k o m a n d i m

I. Të miratohet Raporti vjetor i punës për vitin 2014, i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me Rekomandimet si në vijim:

1. Qeveria të harmonizojë legjislacionin me Direktivat e BE-së, konkretisht të evitojë mospërputhshmërinë e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe Ligjit për komunikime elektronike, sa i përket financimit dhe ruajtjes së pavarësisë së rregullatorit, në këtë rast ARKEP-së;
2. Qeveria në një afat sa më të shpejtë të procedojë në Kuvend kandidatët për kompletimin e Bordit të ARKEP-it;
3. ARKEP-ja të punojë një platformë dhe të sigurojë zbatimin e masave të nevojshme për matjen e standardeve të cilësisë dhe sasisë së shërbimeve të operatorëve ndaj konsumatorëve në komunikimet elektronike e postare;

4. ARKEP-ja të dërgojë informata shtesë më shkrim sa i përket operimeve ilegale dhe për çështjen e ankesave të qytetarëve.

II. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

4. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa